

RENDI I DITËS


Shorti “Për caktimin e relatorit të Kërkesës Ankimore nr. 93 me objekt,
“Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr. 722,
dt.19.08.2023”, subjekti ankues Partia Demokratike e Shqipërisë”

PJESËMARRJA :

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema**

Z. Y. Merkaj: Përshëndetje të gjithëve! Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në datën 20.08.2023, ora 11:20 është paraqitur kërkesa ankimore me ankues Partia Demokratike e Shqipërisë, e cila kërkon ndryshimin e vendimit nr.722, të datës 19.08.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarin e KZAZ-së nr.11, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 24 shtator 2023”. Sot në datën 21.08.2023, ora 10:47, zhvillohet seanca e shortit “Për caktimin e relatorit të kërkesës ankimore nr. 93”. Për këtë i referohemi nenit 14 të rregullores së KAS-it e cila përcakton procedurën e hedhjes së shortit. Për këtë kemi përgatitur 4 shirita letre, ku në njërin prej tyre është shënuar kërkesa ankimore nr. 93, futen në gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë. Tre shiritat e tjerë janë të bardha e pa shënime. Njëri nga anëtarët e KAS-it, zoti Koli Bele nuk do të marrë pjesë në short. Katër shiritat e letrës futen në gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë dhe më pas në një enë transparente. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë të pranishëm, është autorizuar përfaqësuesi i KQZ-së të tërheqë në emër dhe për llogari të tyre goglat për caktimin e relatorit. Vazhdojmë me rendin alfabetik rritës duke filluar së pari me zotin Elvin Lako, Elvis Çefa, Ilirjan Rusmali dhe në fund me zotin Ledio Braho.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.21.08.2023*

Të katër goglat janë në një enë transparente. Pasi përzjehen,

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

Zotit Elvin Lako: – Kërkesa ankimore nr. 93.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

Zotit Elvis Çefa: – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

Zotit Ilirjan Rusmali: – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

Zotit Ledio Braho: – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Në përfundim të procedurës së shortit, zoti Elvin Lako është relator i kërkesës ankimore nr. 93. Ju faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

